

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**PROGRAMI MASTER - DREJTIMI PENAL**



**PUNIM DIPLOME**

**“Lëndimet trupore në territorin e Gjykatës Themelore të Pejës - Dega në  
Istog gjatë periudhës 2015-2019”**

**Mentori:  
Prof. Dr. Rexhep GASHI**

**Kandidatja:  
Edita FERATI**

**Prishtinë, 2023**

## Abstrakti

Rregullimi ligjor i çështjeve të ndryshme nga jeta e përditshme paraqet një ndër sfidat më të mëdha të shtetit tonë i cili edhe pse ende “i brishtë” dhe në hapat e pare të shtetformimit, Republika e Kosovës po synon që çdo ditë e më tepër të kyqet në sistemin e shteteve demokratike dhe të zbatimit të ligjeve duke aspiruar të jap kontributin e vet si shtet me system demokratik në luftën kundër krimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga veprimet kriminale. Ndër gjithë dokumentet, aktet dhe në tërësi legjislacionin vendor Kosova ka të miratuar edhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës, tërësi rregullash këto që rregullojnë në aspektin ligjor veprimet e kundërligjshme dhe si të tilla edhe i sanksionojnë ato, duke dhënë kështu bazë të fortë për vënie të ligjit dhe rendit.

Ndër veprat penale që janë të inkuadruara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me një hulumtim të detajuar janë përzgjedhur lëndimet e rënda dhe lëndimet e lehta trupore nga kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe shëndetit. Ne tashmë e dimë që e drejta e jetës është e drejtë fundamentale, absolute dhe natyrore dhe si të tillë edhe si shoqëri jemi në përpjekje ta mbrojmë nga rreziqet që mund t’i kanosen. Ndër atakimet më të mëdha që i bëhen integritetit fizik dhe atij moral janë vetë kryerja e veprave penale të lëndimit të lehtë trupor dhe lëndimit të rëndë trupor. Dukuritë e tilla janë ende shume prezente në shoqërinë tonë, ndonëse të tillat veprime janë kryer qysh në kohërat e lashta kur mjeti i dhunës është përdorur për të arritur qëllime të ndryshme.

Mirëpo lufta kundër veprimeve kriminale nuk duhet të mungojë asnjëherë dhe duke vepruar në bazë të ligjeve, rregullave, duke shfrytëzuar kapacitetin që dhurojnë institucionet përkatëse dhe duke përdorur mekanizmat mbrojtës të shoqërisë, strategjia për largimin e dukurive kriminale, në rastin konkret, të lëndimeve të lehta dhe të rënda trupore, do të funksionojë dhe do i mundësojë gjeneratave një jetë më të qetë.

Objekti kryesor i këtij punimi qëndron pikërisht tek rregullimi ligjor i veprave penale, lëndim i lehtë trupor dhe lëndim i rëndë trupor, si dhe hulumtimi më i detajuar i këtyre veprimeve të kundërligjshme në mënyrë që të gjendet më lehtë shkaktari, motivi dhe lufta që po bëhet për tu parandaluar dukuritë e tilla.

Po ashtu, ky punim ka për qëllim që të njoftojë lexuesin me nocionet bazë, me vështtrimin juridik të këtyre veprave penale, klasifikimin, karakteristikat e lëndimeve trupore, të bëhet një krahasim mes shtetit të Republikës së Kosovës me shtete të tjera që kanë ngjashmëri gjeografike apo politike me Kosovën, statistikat reale nga arkivat e Gjykatës Themelore Pejë – dega në Istog, dhe si një punim hulumtues të kontribuojë në literaturën juridike për ata që janë të interesuar të zgjerojnë njohuritë e tyre për veprat penale të lëndimeve trupore.

**Fjalët kyçe:** Lëndim i rëndë trupor, Lëndim i lehtë trupor, Vepra penale, Legjislacioni penal, Integriteti fizik dhe shëndeti.